

Boban (Živorad) Matić

(14.02.1973, serb nga fshati Bratotin/Bratotin, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor në KIB Xërxë/Zrze, i pamartuar)

Srećko (Stanomir) Blagojević

(22.05.1985, serb nga Reçani/Rečane, komuna e Suharekës/Suva Reka, nxënës)

Bobani ka qenë pjesëtar i forcave shtesë të policisë. Me familje jetonin në Bratotin/Bratotin deri më 7.05.1998, kur, për shkak të drojës, e braktisën fshatin dhe u strehuan në Hoçën e Madhe/Velika Hoča [Rahovec/Orahovac]. Në datën **22.09.1998**, Bobani me bashkëshorten e të vëllait dhe fëmijët e tyre kanë shkuar në **Reçan/Rečane**, për vizitë të motra Zorica. Po atë ditë, rreth orës 13:30, me djalin e Zoricës, Srećkon, u nisën te farefisi në Mohlan/Movljane. U tha familjarëve që do të ktheheshin shpejt. Ishte kjo hera e fundit që Srećko dhe Bobani shiheshin të gjallë. Në muajin tetor të të njëjtit vit, makina e Bobanit të tipit *Lada Riva* u gjet pranë rrugës në fshatin Budakovë/Budakovo. Zhdukja e Bobanit dhe e Srećkos është regjistruar nga KNKK-ja dhe dosjet e tyre i mbajnë numrat YUK-050047-01 dhe YUK-050047-02.

Burimet: deklarata Z.B, FDH-5958; deklarata S.M, FDH-471; FDH, *Spisak...*, FDH-5515; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; AIS, *Zona...*, 67, FDH-16913; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 355; SMIP, *Teroristički...*, III, 513, 973; FHP, *Otmice...*, 113; *Šta je sa otetima*, Ilustrovana politika, 28.11.1998, FDH-32281; B. Stanojević *Milosrdni...*, 115, 137.

Selman (Ajet) Kadrija

(4.05.1910, shqiptar nga Krushica e Epërme/Gornja Krušica, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, pesë fëmijë)

Familjarët e Selmanit e kanë braktisur Krushicën e Epërme/Gornja Krušica më **27.09.1998**, kur vërejtën se forcat serbe po i afroheshin fshatit. Selmani ndenji në shtëpi [**Krushicë e Epërme/Gornja Krušica**], sepse ishte në moshë, i sëmurë dhe i palëvizshëm. Pas tërheqjes së forcave serbe nga fshati, dy ditë më vonë, djali i Selmanit, Selimi, me një kushëri u kthyen në fshat dhe në brendi të shtëpisë e gjetën

trupin e pajetë të Selmanit me një plagë në gjoks. Një ditë më vonë, e kanë varrosur Selmanin në një livadh përmbi fshat. Pas përfundimit të luftës, në muajin mars të vitit 2001, mbetjet mortore të Selmanit u rivarrosën në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata S.K, FDH-11198; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-24707; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00701, FDH-35931.

Zenel (Idriz) Morina

(28.10.1966, shqiptar nga Staravuçina/Stara Vučina, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Zeneli ka punuar në Austri deri në vitin 1998, përderisa familja i jetonte në Staravuçinë/Stara Vučina. Kur ka mësuar për ngjarjet në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze [të shikohen regjistrimet], ai u kthye në Kosovë dhe aderoi në aradhet e UÇK-së në fshatin Reshtan/Raštane. Më vonë, e risistemuan në shtabin e UÇK-së në Budakovë/Budakovo. Ka shkuar tri herë në Shqipëri për të transportuar armatime në Kosovë. Në mëngjes, më **27.09.1998**, Zeneli me dhjetë ushtarë kanë arritur në **Staravuçinë/Stara Vučina**, ku pritej sulmi i forcave serbe. E njoftuan popullatën për nevojën e braktisjes së fshatit me kohë, ndërkaq ata i zunë pozicionet. Sulmi ka filluar rreth orës 9:00. Një plumb e ka qëlluar Zenelin dhe e ka lënë të vdekur në vend. Ditën tjetër, bashkëluftëtarë të tij me disa komshinj e kanë varrosur Zenelin në livadhin e tij në Staravuçinë/Stara Vučina. Pas përfundimit të luftës, më 18.09.1999, mbetjet mortore të Zenelit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Suharekë/Suva Reka.

Burimet: deklarata N.M, FDH-11207; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-19086; fotografi, FDH-20988; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00701, FDH-35931; UÇK, *Lista e dëshmoreve...*, FDH-36427.

Arif (Maliq) Ndrecaj

(1909, shqiptar nga Maqiteva/Maçitevo, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, shtatë fëmijë)